



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 25/1 Prot.

Tiranë, më 25/1 /2011

Lënda: Rekomandim për “**Instituti i dobësimit Orchid**” Tiranë.

REKOMANDIM

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, “**Instituti i dobësimit Orchid**” Tiranë,

KONSTATOVA

Më datë 16/05/2011 nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar inspektimi administrativ pranë kontrolluesit, “**Instituti i dobësimit Orchid**” Tiranë, me objekt:

- Verifikimi i ankesës së shtetasit me inicialet A.B, lidhur me mesazhet promociionale të dërguara nga “**Instituti i Dobësimit Orchid**”.

Komisioneri “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ të mbajtur me këtë rast si dhe provat e administruara vëren se:

Kontrolluesi “**Instituti i Dobësimit Orchid**” ka dërguar komunikime tregtare me karakter reklame përmes mesazheve të tipit sms-të shkruara, drejt numrave të ndryshëm përdoruesish të telefonisë celulare (AMC, Vodafon, Eagle), pa marrë pëlqimin paraprak nga subjektet e të dhënave personale, (mbajtës dhe përdorues të numrave të telefonave celularë) për ofrimin e këtij shërbimi.

Nga inspektimi administrativ i kryer rezultoi se, dërgimi i sms-ve promociionale është bërë nga vetë administratorja e këtij kontrolluesi. Mesazhet promociionale janë realizuar nëpërmjet blerjes së një shërbimi për dërgim mesazhesh në internet, ofruar nga kontrolluesi “Eder Studio”.

